

B A S H K I M I  
E V R O P I A N  
I S Q A R U A R



# Arsimi, trajnimi, rinia dhe sporti

Arsimi dhe  
trajnimi - çelës  
i ardhmërisë  
tuaj

Investimet në arsim dhe trajnim janë  
vendimtare për përmirësimin e  
zhvillimit personal të të rinjve dhe  
perspektivës për punësimin e tyre.



# BASHKIMI EVROPIAN I SQARUAR

*Ky publikim është pjesë e serisë që sqaron punën e BE-së në fusha të ndryshme të politikës, pse është e përfshirë BE-ja dhe cilat janë rezultatet.*

*Publikimet mund t'i gjeni në:*

[http://europa.eu/pol/index\\_en.htm](http://europa.eu/pol/index_en.htm)  
<http://europa.eu/!bY34KD>

Si funksionon BE-ja Evropa në 12 leksione  
Evropa 2020: Strategjia zhvillimore e Evropës  
Themeluesit e BE-së

Bujqësia  
Bankat dhe financat  
Kufijtë dhe siguria  
Buxheti  
Veprimet lidhur me klimën  
Konkurrenca  
Konsumatorët  
Kultura dhe politika audiovizuale  
Dogana  
Agjenda digjitale  
Unioni ekonomik dhe monetar dhe euroja  
**Arsimi, trajnimi, rinia dhe sporti** ✘  
Punësimi dhe çështjet sociale  
Energjia  
Zgjerimi  
Ndërmarrjet  
Mjedisi  
Lufta kundër falsifikimit  
Siguria e ushqimit  
Politika e jashtme dhe politika e sigurisë Ndhima  
humanitare dhe mbrojtja civile  
Tregu i brendshëm  
Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe zhvillimi Drejtësia,  
të drejtat themelore dhe barazia Çështjet  
detare dhe të peshkimit  
Migracioni dhe azili  
Shëndeti publik  
Politika rajonale  
Hulumtimi dhe inovacioni  
Tatimi  
Tregtia  
Transporti

## PËRMBAJTJA

Pse na duhet veprimi evropian . . . . .	3
Si vepron BE-ja për këtë . . . . .	6
Çfarë bën BE-ja . . . . .	10
Perspektiva . . . . .	16
Mësoni më tepër . . . . .	16

---

### **Bashkimi Evropian i sqaruar: Arsimi, trajnimi, rinia dhe sporti**

Komisioni Evropian  
Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim  
Informimi i qytetarëve  
1049 Bruksel  
BELGJIKË

Doracaku u azhurnua në nëntor 2014

Ballina dhe fotografia në faqen  
2: © Glowimages/Getty Images

16 pp. — 21 × 29.7 cm  
ISBN 978-92-9238-361-9  
doi: 10.2871/201760

Luksemburg: Zyra e Publikimeve  
e Bashkimit Evropian, 2014

© Bashkimi Evropian, 2014  
Riprodukimi është i autorizuar. Për çdo përdorim ose  
riprodukim të fotografive, duhet të kërkohet leje  
drejtpërdrejtë nga autori.

---

## Pse na duhet veprimi evropian?

### Arsimi dhe trajnimi — për ardhmërinë tuaj — për ardhmërinë tonë

**Për ju:** Investimi në arsim dhe trajnim është çelësi i ardhmërisë suaj, sidomos nëse jeni i ri. Mësimi i një gjuhe të dytë ose të tretë, jo vetëm që do t'ua lehtësojë të merrni dije për vendet e tjera, popujt dhe mënyrat e ndryshme të jetesës. Gjithashtu krijon mundësi që të mësoni ose të trajnoheni jashtë vendit dhe të përmirësoni perspektivën tuaj për një vend pune të paguar mirë dhe i cili ju përmbush në të ardhmen. Studimet tregojnë se njerëzit shumëfish të kualifikuar kanë dy herë më shumë gjasa për t'u punësuar dhe pothuajse tri herë më shumë gjasa të fitojnë të ardhura mbi mesataren, në krahasim me njerëzit me pak kualifikime.

**Për vendin tuaj:** Në një botë që po bëhet gjithnjë e më e ndërvarur, ekonomitë nacionale do të arrijnë potencialin e vet të plotë, vetëm nëse mbështeten me sisteme të fuqishme të arsimit dhe trajnimit. Një vend që investon me mençuri në arsim dhe trajnim do të përparojë në biznes, shkencë dhe në art. Përveç kësaj, garantimi i mundësive arsimore për të gjithë do të ndihmojë në sigurimin e drejtësisë sociale dhe kohezionit social.



Arsimi ishte thelbësor për lulëzimin e qytetërimit klasik grek.

### A e dini se?

20 % e evropianëve kanë nivel të ulët të aftësive themelore siç janë shkrim-leximi dhe aritmetika, gjë që e vështirëson qasjen e tyre në tregun e punës dhe pjesëmarrjen e plotë në shoqëri.

**Për Evropën:** Suksesi ynë në një treg konkurrues global mbështetet në forcën e kualifikuar punëtore që prodhon mallëra dhe shërbime të shkëlqyeshme dhe inovative. Mirëpo, arsimi nënkupton shumë më tepër se sa rezultatet ekonomike: një kulturë demokratike në Evropë mund të arrijë sukses vetëm nëse të gjithë ne jemi të vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë tona qytetare. Shtetësia aktive duhet të mësohet në shtëpi, në shkollë dhe jashtë.

### Erasmus+

Në funksion të rolit kyç të arsimit për mirëqenien e ardhshme të qytetarëve, popujve dhe Evropës në tërësi, BE-ja ka përpiluar një program ambicioz: Erasmus+. Programi ka për qëllim të përmirësojë zhvillimin personal dhe perspektivat e punësimit të njerëzve. Ai mbështet të gjithë sektorët e arsimit dhe trajnimit, si dhe mësimin joformal për të rinjtë, vullnetarizmin dhe sportet bazë. Ky program zëvendëson disa programe paraprake, me rregulla dhe procedura të modernizuara e të thjeshtësuara të aplikimit.

Që nga viti 1987, më se 3 milionë studentë të arsimit të lartë kanë përfituar nga grantet Erasmus. Erasmus+ ka shtuar dukshëm fondet e BE-së. Programi ka për qëllim të mbështesë edhe 4 milionë të rinj, studentë dhe të rritur, në periudhën 2014-2020, që të fitojnë përvojë dhe kualifikime përmes mësimi, trajnimit, me anë të këmbimeve rinore ose vullnetarizmit jashtë vendit. Gjithashtu shton dukshëm mundësitë për bashkëpunim mes institucioneve arsimore ose organizatave rinore si dhe mes botës së arsimit dhe asaj të punës.

## Shifra alarmante — boshllëku i kualifikimeve

Kriza globale ekonomike ka ekspozuar dobësi strukturore me pasoja të rënda për miliona njerëz. Shkalla e papunësisë së të rinjve ka tejkaluar 20 % në BE, në tërësi, kurse te disa shtete anëtare ajo është mbi 50 %. Megjithatë, kriza nuk është shkaku i vetëm i papunësisë. Arsimiti i dobët dhe mungesa e kualifikimeve gjithashtu kontribuojnë në papunësi.

### A e dini se?

*Të mos jeni në gjendje të shkruani dhe të lexoni, jo vetëm që shkatërron jetën por sjell edhe shpenzime të mëdha për shoqërinë. Kostoja e analfabetizmit — vetëm në vendet e zhvilluara — arrin vlerën në më se 500 000 000 000 euro (500 miliardë euro) çdo vit.*

Rreth 20 % e të rinjve në BE nuk e arrijnë shkallën minimale të aftësive themelore të leximit, matematikës dhe shkencës. Gjashtë milionë braktisin arsimin dhe trajnimet, ndaj mbeten vetëm me shkollë fillore, të mesme ose më pak. Mund të imagjinoni ndikimin e këtyre të metave: një studim i fundit zbuloi se vetëm një nga dy të rritur me nivel të ulët të aftësive është i punësuar, kurse shkalla e punësimit për të rriturit më të kualifikuar është dukshëm më e lartë.

A do të thotë kjo se fitimi i kualifikimeve është rruga më e mirë për të gjetur një punë? Padyshim është rruga më e sigurt. Shumë punëdhënës kërkojnë urgjentisht punëtorë të kualifikuar. Një nga tre punëdhënës e ka të vështirë të gjejë njerëz me kualifikimet e duhura. Kjo është veçanërisht e vërtetë në sektorët më inovativ të ekonomisë, ku ka mijëra vende të lira të punës në fushën e inxhinierisë, shkencës dhe teknologjisë.

Kjo mospërputhje mes kualifikimeve që kërkohen nga punëdhënësit dhe ato që ofrohen nga personat që kërkojnë punë quhet **boshllëku i aftësive**. Ky është një nga problemet më akute me të cilat përballen vendet e Evropës. Për të mbyllur këtë boshllëk nevojiten ura. Urat më të forta janë arsimimi dhe trajnimi.

### Pensionistët mbyllin boshllëkun

Projekti evropian **HEAR ME** ("më dëgjo" - shkurtesë nga - Pensionistët me arsim të lartë mentorojnë personat që braktisin shkollimin para kohe) ka punësuar pensionistë ose persona afër pensionimit dhe kanë dëshirë të punojnë me të rinj. Vullnetarët morën pjesë në disa kurse për aftësi të mentorimit. Pastaj pensionistët vepruan si mentorë, duke ofruar ndihmë dhe udhëzime për personat me nevoja të veçanta që braktisin shkollën para kohe, për të mbështetur qëllimet e tyre arsimore dhe të punësimit.



*Prodhuesit janë duke luftuar për të gjetur punëtorë të kualifikuar*



*Subsidiariteti në praktikë: atë që e mësoni në shtëpi, nuk është e nevojshme ta mësoni në shkollë.*

## Trajtimi i sfidave së bashku

Miliona njerëz dhe organizata janë të përfshira në procesin e mësimin; nga studentë, stazhierë dhe prindër, deri në mësimdhënës, universitete, ndërmarrje dhe organizata rinore e deri në qeveri dhe në BE. Si mund t'i ndajnë përgjegjësitë e tyre përkatëse në mënyrë të mençur? **Parimi i subsidiaritetit** ofron udhëzime. Kjo do të thotë se vendimet duhet të merren gjithnjë sa më afër njerëzve përkatës

### Përgjegjësitë në arsim - çfarë mendoni ju?

*Kush e ka rolin më të rëndësishëm në procesin e arsimit dhe trajnimit? Qeveritë, shkollat, mësimdhënësit apo prindërit?*

*Cili është roli juaj?*

*Deri në çfarë mase mund të vendosni ju se ku, kur dhe çfarë të mësoni?*

Prandaj — në bazë të traktateve të BE-së - çdo vend i BE-së është përgjegjës për të përpiluar politikat e veta të arsimit, trajnimit dhe politikën rinore. Qeveritë nacionale janë ato që do të vendosin përmbajtjen e mësimdhënies dhe organizimin e arsimit. Çdo qeveri, nga ana tjetër, është e lirë të lejojë që çështjet arsimore të trajtohen në nivel rajonal dhe lokal. Shumë vendime u delegohen më tej universiteteve, shkollave dhe institucioneve trajnuese. Disa nga to janë të implementuara nga organizatat rinore.

Mirëpo, përt' u arritur progres, njohuria duhet të zhvillohet dhe të zgjerohet, duke përfshirë këtu edhe kalimin e kufijve. Këtu hynë në përdorim dimensionin evropian në politikat e arsimit, trajnimit dhe rinisë. Shtetet anëtare mund t' i përmirësojnë politikat e tyre, duke mësuar nga përvojat e njëri - tjetrit; studentët, stazhierët, vullnetarët, mësimdhënësit, punëtorët e rinj, shkollat, universitetet dhe organizatat rinore mund të bashkëpunojnë jashtë kufijve. Bashkëpunimi në nivel evropian është i domosdoshëm për të krijuar mjediset më të mira të mësimin për të gjithë dhe për të dhënë kualifikimet e çmuara lartë.

Rrjedhimisht, programet e bashkëpunimit në fushën e arsimit, trajnimit dhe rinisë, janë në agjendën evropiane vite me radhë: programi Erasmus u miratua në vitin 1987, kurse programi i parë rinor i Evropës 'Rinia për Evropën' në vitin 1988. Mirëpo, deri në Traktatin e Mاستrihtit (1993), kompetencat zyrtare evropiane në fushën e arsimit, trajnimit profesional dhe rinisë nuk ishin përfshirë në traktatet themeluese të Unionit.

### A e keni ditur?

*Sporti u shtua si kompetencë e re e BE-së në Traktatin e Lisbonës (2009). Rëndësia e një qëndrimi mbarë- evropian është e qartë kur bëhet fjalë për promovimin e përfitimeve sociale dhe ekonomike të pjesëmarrjes në sport dhe në aktivitete fizike, si dhe kur duhet të trajtohen kërcënimet ndaj sportit, siç janë kurdisja i ndeshjeve, dhuna në sport ose doping. Këmbimi i informatave në nivel të BE-së, ndihmon shtetet anëtare të hartojnë politika efektive për t'iu kundërvënë sfidave të këtylla.*

## Si vepron BE-ja për këtë

BE-ja angazhohet për të hapur dyert e mundësive përmes mbështetjes së politikës së arsimit, trajnimit dhe rinisë.

### Zhdukni paragjykimet: nxënia e mësimit ndodh në vazhdimësi

'Jeta është mësimit; kur nuk mësoni më, atëherë vdisni' (Tom Clancy).

**Mësimi ndodh në vazhdimësi.** Duke folur me dikë që nuk e keni njohur më parë, ju jepet mundësia që të mësoni qëndrimet, preferencat e tij ose të saj, etj.

### Është pothuajse e pamundur të mos mësoni.

Mundohuni t'i shmangeni .mësimin vetëm për një orë. A mund të arrini sukses?

Nuk mundeni. Madje edhe nëse përgatiteni për këtë eksperiment, do të duhet të mendoheni se nga cilat aktivitete të përmbaheni. Si rezultat i kësaj — me anë të përvojës tuaj — do të zhvilloni një qëndrim më të qartë për atë se çfarë është mësimit. Përvoja personale është mënyra më e mirë e mësimit.

### Të mësuarit është më shumë se të qëndrosh ulur në klasë.

Është më shumë se sa të absorbosh fakte. Të mësosh është të jetosh.

Rrjedhimisht, BE-ja promovon një qasje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse ndaj mësimit, e cila përfshin një varg metodash të ndryshme mësimore dhe mjedisë mësimore, për shembull mësimit joformal, jozyrtar dhe mësimit gjatë tërë jetës.



Të mësosh do të thotë të jetosh



Mësimi i solidaritetit, mësimit për jetën.

**Mësimi joformal** nënkupton mësimit jashtë mjedisit zyrtar shkollor ose të trajnimit dhe bëhet me anë të aktiviteteve të organizuara që përfshijnë ndonjë formë të mbështetjes mësimore, për shembull:

- mësimit i strukturuar online;
- trajnimit brenda kompanisë;
- vullnetarizmi ose pjesëmarrja në këmbime rinore;
- programet që adresojnë aftësitë e shkrim-leximit për personat që braktisin shkollën para kohe ose aftësi që kanë të bëjnë me punën.

**Mësimi jozyrtar** nënkupton mësimit që nuk është i organizuar ose i strukturuar për sa i përket qëllimeve, kohës ose mësimoreve. Këtu përfshihen shkathtësitë e fituara (ndonjëherë padashur) nga përvoja jetësore dhe e punës.

Për shembull:

- kualifikimet e menaxhimit të projekteve ose të teknologjive të informimit që janë fituar në punë;
- gjuhët dhe shkathtësitë ndërkulturore të fituara gjatë qëndrimit jashtë vendit;
- shkathtësitë sociale të fituara me anë të vullnetarizmit, aktiviteteve kulturore, sportit dhe me anë të aktiviteteve në shtëpi (për shembull kujdesi ndaj një fëmije).

**Mësimi gjatë tërë jetës** nënkupton mësimin e gjërave të reja gjatë jetës, sidomos pasi që të keni përfunduar arsimin zyrtar fillestar. Mbani në mend: asnjëherë nuk është vonë të mësoni!

### Mësimi gjatë tërë jetës për personat me aftësi të kufizuara intelektuale

*Për personat me aftësi të kufizuara intelektuale, mësimi gjatë tërë jetës nuk është vetëm nxënia e shkathtësive të reja. Ky mësim gjithashtu ka të bëjë me përfshirjen në shoqëri, të qenit i aftë për të mbrojtur veten dhe kontrollimin e jetës së përditshme. Mirëpo, shumë kurse të trajnimit nuk janë të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Shpesh, materialet mësimore janë të ndërlikuara për t'u marrë vesh dhe është e vështirë të kuptohet se çfarë flet mësimdhënësi.*

*Prandaj organizatat e shumë vendeve të BE-së janë bashkuar dhe kanë themeluar projektin "Pathways" (shtigjet). Pjesëmarrësit kanë hartuar kurse për trajnim, broshura dhe mjete online, duke sqaruar mënyrën për qasje më të mirë në informata. Ky projekt do ta lehtësojë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara intelektuale në mësimin gjatë tërë jetës.*

### Hapni derën tuaj: bashkëpunimi me botën

Evropa nuk është një dyqan i mbyllur - sidomos kur bëhet fjalë për arsimin, trajnimin dhe politikën rinore.

- BE-ja mbështet bashkëpunimin në gjithë botën, duke synuar zhvillimin dhe modernizimin e institucioneve të arsimit të lartë në vendet partnere. Institucionet partnere mund të zgjedhen në vendet fqinje të BE-së, të Ballkanit Perëndimor dhe Rosisë, si dhe rajonet në Azi, Amerikë Latine dhe Afrikë.

- BE-ja mbështet projektet e bashkëpunimit mes organizatave rinore në mbarë botën. Këto projekte kanë për qëllim të përmirësojnë cilësinë dhe njohjen e punës së të rinjve, vullnetarizmin, shkëmbimet rinore dhe aktivitetet e tjera të mësimin joformal në rajone të ndryshme të botës.

- Programi **Jean Monnet** inkurajon mësimin, hulumtimin dhe reflektimin mbi integrimin evropian në mbarë botën. Në periudhën mes viteve 1990 dhe 2011, programi Jean Monnet ka ndihmuar themelimin e rreth 3 700 projekteve në fushën e studimeve për integrim evropian, duke përfshirë 165 Qendra Evropiane të përsosmërisë Jean Monnet, rreth 880 udhëheqës të universiteteve dhe pothuajse 2 200 kurse permanente dhe module evropiane. Ky program tani operon në 72 vende të botës.

### Promovimi i njohurisë mbi BE-në në gjithë botën

*'Aksioni Jean Monnet është vërtetë vital. Programi ekonomik tani shërben si mjet për zhvillimin e planprogrameve që kanë të bëjnë me BE-në, duke ftuar akademikët dhe praktikantët evropianë ... dhe duke promovuar aktivitete të ndryshme për të ngritur vetëdijen e publikut korean rreth BE-së.'*

Profesor Woosik Moon, kryesues i Ekonomiksit të BE-së në Universitetin Nacional të Seulit, në Korenë Jugore.

### BE-ja luan rol mbështetës

Shtetet Anëtare mbajnë përgjegjësinë për përmbajtjen dhe organizimin e sistemeve të tyre të arsimit dhe trajnimit profesional. BE-ja respekton shumëllojshmërinë e rregullave dhe prioriteteve nacionale dhe nuk ka të drejtë t'i harmonizojë ligjet dhe rregullativat e shteteve të veta anëtare në këto fusha (Nenet 165 dhe 166 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian).

Prandaj, BE-ja nuk është në pozitë të formulojë rregullat mbi arsimin, trajnimin dhe politikën rinore. A nënkupton kjo që BE-ja vetëm qëndron duarkryq dhe shikon? Jo, aspak! BE-ja luan rol unik në procesin e mësimin evropian si koordinator, moderator dhe këshilltar. BE-ja inkurajon bashkëpunimin mes shteteve anëtare dhe plotëson veprimet e tyre. Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

Kjo do të thotë, për shembull se BE-ja:

- **mbështet** studentët, kandidatët për doktoraturë, stazhierët, mësimdhënësit, trajnuesit dhe ligjëruesit për të mësuar, ligjëruar ose për të fituar përvojë pune jashtë vendit, kurse të rinjtë të marrin pjesë në shkëmbime rinore ose të paraqiten vullnetarë jashtë vendit;
- **inkurajon** Shtetet Anëtare të reformojnë dhe modernizojnë sistemet e tyre arsimore dhe trajnuese dhe të hartojnë politika rinore, në mënyrë që ata të jenë më të përgatitur për të trajtuar sfidat e sotme dhe sfidat e së ardhmes;
- **lehtëson** integrimin e njerëzve në tregun e punës, sidomos me anë të arsimit dhe trajnimit profesional;
- **promovon** bashkëpunimin mes qeverive, universiteteve, gjimnazeve dhe shkollave, institucioneve trajnuese, ndërmarrjeve, partnerëve socialë, organizatave rinore dhe të shoqërisë civile.

## Pse të bashkëpunohet në nivel të BE-së?

Bashkëpunimi në nivel të BE-së ndihmon vendet e Evropës të përmirësojnë sistemet e tyre arsimore. U mundëson vendeve të punojnë së bashku dhe të mësojnë nga njëra tjetra duke ndarë praktikat më të mira të politikës.

## Bashkëpunimi në nivel të BE-së: semestri evropian

Evropa 2020 është strategjia e BE-së për zhvillim ekonomik dhe krijim të vendeve të punës. Guri themeltar i saj është semestri evropian, i themeluar në vitin 2011 si një cikël vjetor i koordinimit të politikës ekonomike dhe dialogut që përfshin institucionet evropiane, qeveritë e BE-së dhe parlamentet nacionale. Në suaza të këtij ushtrimi, BE-ja miraton **rekomandime specifike sipas vendit**, të cilat kanë për qëllim të udhëzojnë shtetet anëtare se si të garantojnë konkurrencë dhe krijim të vendeve të punës. Meqë arsimit dhe trajnimit kanë rëndësi gjithnjë e më të madhe për punësimin dhe zhvillimin ekonomik, rekomandimet specifike sipas vendit gjithashtu adresojnë – dukshëm dhe gjithnjë e më shumë – çështje që kanë të bëjnë me arsimin dhe trajnimitin

## Bashkëpunimi në nivel të BE-së: tabela e rezultateve të lëvizshmërisë

*Me pjesëmarrjen e Shteteve Anëtare, BE-ja ka hartuar një tabelë të rezultateve të lëvizshmërisë. Tabela e rezultateve identifikon pesë faktorë kryesorë që ndikojnë në motivimin dhe aftësinë e të rinjve për të studiuar dhe për t'u trajnuar jashtë vendit. Duket se (nga muaji janar 2014), mbështetja dallon dukshëm në Shtetet e ndryshme Anëtare.*

- Gjermania, Belgjika, Spanja, Franca dhe Italia ofrojnë informatat dhe udhëzimet më të përgjithshme lidhur me mundësitë e lëvizshmërisë.  
Qiproja, Luksemburgu dhe pjesa
- gjermanofolëse e Belgjikës vë theksin më të madh në gjuhën që mësohet nëpër shkollë. Ky është shpesh një faktor me rëndësi kur merret vendim për të mësuar, trajnuar ose për të punuar jashtë vendit.
- Pjesa flamane e Belgjikës, Gjermania, Italia dhe Austria janë në favor të mbështetjes të formuluar mirë financiare për studentët nga mjedise të pafavorizuara shoqërore, të cilët dëshirojnë të studiojnë ose të trajnohen jashtë vendit.

## BE-ja synon caqe ambicioze

Mësimi nënkupton përparim. E njëjta vlen edhe për politikat e arsimit dhe trajnimit. Prandaj, për të matur progresin, BE-ja dhe Shtetet e veta Anëtare caktojnë standardet në vijim, të cilat duhet të arrihen deri në vitin 2020.


- Përqindja e 15 vjeçarëve me aftësi të pamjaftueshme të leximit, matematikës dhe shkencës duhet të jetë më e vogël se 15 %.
- Shkalla e personave që braktisin shkollën para kohe duhet të zvogëlohet në më pak se 10 %.



- Së paku 40 % përqind e të rriturve të rinj duhet të mbarojnë shkollimin e lartë.
- Së paku 20 % e të diplomuarve në arsim të lartë duhet të kalojnë një periudhë mësimi ose trajnimi jashtë vendit.

Ku qëndrojmë sot? A jemi në rrugë për të arritur qëllime ambicioze të caktuara për vitin 2020? Sipas anketës PISA 2012 pasqyra është e përzier.

Cilido qoftë rezultati në tema të caktuara, ose për vende përkatëse, mbetet edhe shumë për t'u bërë. Përderisa miliona të rinj në BE kanë vështirësi në lexim, shkrim dhe matematikë, nuk mund të rrijmë dhe të relaksohemi.



Estonia (ky është kryeqyteti Tallin) ofron mundësi të barabarta për mësim.

## Anketa PISA 2012

Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA) është studim mbarë botëror nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). PISA vlerëson shkallën në të cilën nxënësit 15 vjeçarë kanë fituar njohuritë dhe aftësitë kryesore në matematikë, lexim dhe shkencë. Anketa e parë u realizua në vitin 2000, dhe prej atëherë ky vlerësim është përsëritur çdo 3 vjet. Të gjitha 34 vendet anëtare në OECD-së dhe 31 vendet dhe ekonomitë partnere kanë marrë pjesë në PISA 2012. Këtu kemi disa nga rezultatet.

## BE-ja po përmirësohet në fushën e leximit dhe shkencës!

BE-ja është në rrugë drejt arritjes së standardeve për shkallë më të ulët se 15 % të nxënësve me aftësi të pamjaftueshme në vitin 2020.

**Lexim:**

23.1 % në 2006 → 17.8 % në 2012

**Shkencë:**

20.3 % në 2006 → 16.6 % në 2012

## Kemi mbetur prapa në matematikë!

Përqindja mesatare e nxënësve me arritje të ulëta në matematikë ka mbetur kryesisht e njëjtë në PISA 2012 (22.1 %) në krahasim me PISA 2009 (22.3 %).

## Disa vende shquhen!

Katër Shtete Anëtare të BE-së (Estonia, Finlanda, Polonia dhe Holanda) janë ndër vendet e para me performancë më të mirë, me përqindje të arritjeve të ulëta në matematikë, më të mirë se përqindja standarde e BE-së 15 %.

Estonia është më e mira në klasa për sa i përket proporcionit të arritjeve të ulëta në matematikë: vetëm 10.5 % (në krahasim me 22.1% në BE në përgjithësi).

## Të tjerët janë shumë prapa!

Disa Shtete Anëtare të BE-së janë në mes të një të tretës ose gjysmës së rezultatit të 15 vjeçarëve në nivelin më të ulët PISA.

## Çfarë bën BE-ja

BE-ja investon 14.7 miliardë euro në Erasmus+, programi i BE-së për arsim, trajnim, rini dhe sport për periudhën 2014–20.

Erasmus+ synon të shtojë perspektivat e vendeve të punës dhe zhvillimin personal të të rinjve. Ky program ndihmon arsimin tonë, trajnimin dhe sistemet rinore, ofron ligjërime, mësim dhe aktivitete rinore që i pajisin njerëzit me kualifikimet e nevojshme për tregun e punës dhe shoqërinë e sotme dhe të ardhshme.

Nëse ju intereson financimi i BE-së për arsim, trajnim, rini dhe sport, informatat thelbësore do t'i gjeni këtu. Informata më të hollësishme janë në dispozicion në Doracakun e programit për aplikuesit. Doracakun e programit dhe shumë informata të tjera do t'i gjeni në ueb faqen Erasmus+ (<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>).

### Erasmus+ ka tre veprime kyçe

- Veprimi kyç 1 — Lëvizshmëria e të mësuarit: mbështetja për studim, punë, pjesëmarrja në aktivitete rinore, ligjërime, trajnim ose zhvillimi i aftësive profesionale dhe personale dhe kompetencave jashtë vendit.
- Veprimi kyç 2 — Bashkëpunimi dhe partneriteti: mundësitë për partneritete bashkëpunuese mes organizatave arsimore, trajnuese dhe rinore, si dhe mes botës së arsimit dhe punës.

- Veprimi kyç 3 — Reforma e politikës: mbështet proceset e reflektimit, dialogun dhe ndërtimin e fakteve të nevojshme për të bërë reformën e arsimit, trajnimit dhe politikave dhe sistemeve rinore.

### Veprimi kyç 1: Lëvizshmëria e mësimit të individëve

Kjo pjesë përcakton mundësitë Erasmus+ për të gjithë nxënësit dhe personelin arsimor, trajnues dhe organizatat rinore.

A jeni ...

... student i arsimit të lartë dhe doni të mësoni ose bëni trajnim jashtë vendit?

... në arsim ose trajnim profesional dhe dëshironi të zgjeroni shkathtësitë tuaja?

... një i ri që do të përfitojë nga këmbimi rinor ose të punojë si vullnetar jashtë vendit?

... mësimdhënës, i punësuar ose punëtor rinor, që dëshiron të ligjërojë ose të trajnohet jashtë vendit?

Kjo pjesë mund të përmbajë informata lidhur me mundësi të reja për ju.

### Gjuhët për njerëzit në lëvizje

*Sa më të mira janë shkathtësitë tuaja gjuhësore, aq më shumë do të përfitoni nga koha që do ta kaloni jashtë vendit. Praktikimi i gjuhëve të ndryshme është një aspekt me rëndësi pothuajse në të gjitha aktivitetet e lëvizshmërisë. Nëse jeni student universitar, vullnetar ose i punësuar që largoheni për së paku 2 muaj, ose praktikant profesional që qëndron jashtë shtetit për së paku 1 muaj, Erasmus+ ju ofron mundësinë të ripërtrini njohurinë tuaj të gjuhës që do ta përdorni për mësim, punë ose si vullnetar.*

*Pas miratimit të aplikimit tuaj për lëvizshmëri, nga ju do të kërkohet t'i kontrolloni kompetencat tuaja gjuhësore dhe do t'ju ofrohet një kurs i gjuhës qoftë para se të shkoni jashtë vendit ose gjatë qëndrimit tuaj atje. Kontaktoni me institucionin ose organizatën tuaj amë për të mësuar më tepër mbi këtë mundësi të re që ofrohet nga Erasmus+. Rifreskoni aftësitë tuaja gjuhësore dhe bëhuni gati të lëvizni!*

## STUDENTËT NË ARSIMIN E LARTË

Periudhat e studimit: studentët mund të kalojnë 3 deri në 12 muaj në studime në ndonjë universitet ose kolegji në një vend tjetër.

Trajnime: ata mund të bëjnë trajnim në një vend pune jashtë shtetit me kohëzgjatje prej 2 deri në 12 muaj.

Të diplomuarit e fundit të arsimit të lartë gjithashtu mund të bëjnë trajnim jashtë vendit përbrenda një viti pas diplomimit. Mirëpo planifikoni para kohe! Universiteti ose kolegji juaj duhet t'u përzgjedhë gjatë vitit tuaj të fundit të studimeve.

Erasmus+ gjithashtu mbështet disa studentë evropianë të studiojnë në vende tjera të botës dhe studentë nga vende tjera të studiojnë në Evropë.

*'Studimi në universitet tjetër më ndihmoi të zgjeroj horizontin e fushës sime të studimit si kurrë më parë. Mirëpo, pjesa më e mirë e kësaj përvoje ishte që takova shumë njerëz me të cilët jam i sigurt që do të punoj në të ardhmen.'*

Roberti (Britani e Madhe) lidhur me studimin e dizajnit industrial për 10 muaj në Universitetin e Teknologjisë në Delft, Holandë.

## KREDITË STUDENTORE PËR MASTER

Erasmus+ mbështet kreditë e reja me kosto të ulët për t'u ndihmuar studentëve të masterit të studiojnë are në vende të tjera evropiane. Studentët mund të aplikojnë

për kredi të favorshme për shkallë të plotë masteri jashtë vendit dhe mund të huazojnë deri në 12 000 euro për një kurs 1-vjeçar ose deri në 18 000 euro për një kurs 2-vjeçar.

## SHKALLËT E PËRBASHKËTA MASTER

Erasmus+ u ofron studentëve të masterit në mbarë botën mundësinë për bursë, në mënyrë që të ndjekin programe të përbashkëta studimi të nivelit të lartë ndërkombëtar, të cilat organizohen nga partneritete universitare. Programet e përbashkëta të masterit ofrojnë shkallë të përbashkët nga të gjitha ose vetëm nga disa nga institucionet pjesëmarrëse. Më shumë informata mund të merrni nga zyra ndërkombëtare e institucionit tuaj të arsimit të lartë.

## LËVIZSHMËRIA NË ARSIMIN DHE TRAJNIMIN PROFESIONAL

Lëvizshmëria jashtë vendit mund t'u ndihmojë të rinjve në arsimin dhe trajnimin profesional të fitojnë kualifikimet e nevojshme për tregun e sotëm konkurrues të punësimit.

Nxënësit e shkollave të larta në shkollat e trajnimit profesional, stazhistët dhe praktikantët mund të realizojnë një stazh ose trajnim jashtë vendit, ku nikoqir mund të jetë ndonjë kompani, vend pune (për shembull OJQ ose organizatë publike) ose shkollë profesionale, me një periudhë të mësimin në vend të punës në një kompani. Trajnimet mund të zgjasin nga 2 javë deri në 1 vjet.



*Zgjeroni horizontet tuaja; studjoni jashtë vendit.*



Grubulloni përvojë profesionale në ndonjë vend që është i njohur për ekspertizën e vet.

Të sapo diplomuarit (ish praktikantë), gjithashtu mund të marrin pjesë në aktivitete të lëvizshmërisë. Ata duhet të realizojnë trajnimin e tyre përbrenda 1 viti pas kualifikimit.

*Përvoja ime e lëvizshmërisë pa dyshim më ka ndihmuar më tej në karrierën time. Pa atë, nuk do të kisha besimin që të aplikoj në konkursin për Kuzhinierë të Re të Vitit, e aq më pak se do ta fitoj atë. Këtë do t'ia rekomandoja shumë të gjithëve. Udhëtimi im në Francë ishte, dhe deri më sot është një nga kujtimet e mia më të mira.'*

Deborah (Britani e Madhe) mbi përvojën e trajnimit në vend pune në Lion, Francë.

Nëse jeni të interesuar për të aplikuar, duhet t'i drejtoheni institucionit tuaj për arsim dhe trajnim profesional.

### LËVIZSHMËRIA E TË RINJVE: KËMBIMET RINORE DHE PJESËMARRJA NË SHËRBIMIN VULLNETAR EVROPIAN

**Shkëmbimet rinore** u ndihmojnë të rinjve të fitojnë aftësi, të tilla si menaxhimi i projekteve dhe puna ekipore. Mundësitë e tilla jashtë mjedisit shkollor, u mundësojnë grupeve të të rinjve të ndërmarrin një program të strukturuar të aktiviteteve (siç janë punëtoritë e kombinuara, ushtrimet, debatet dhe simulimi i roleve) në ndonjë vend tjetër përbrenda ose jashtë BE-së për një periudhë deri në 21 ditë.

Shërbimi Vullnetar Evropian ofron mundësi ideale që të rinjtë të zhvillojnë aftësi personale dhe profesionale, duke kontribuar deri në 12 muaj në punën e përditshme të organizatave, në fusha siç janë kujdesi social, mjedisi, programet e arsimit jo zyrtar, Teknologjitë e Informimit dhe Komunikimit, kulturë dhe shumë të tjera. Kjo është gjithashtu një mundësi për ata të zhvillojnë vetëbesimin, të ndjehen më të angazhuar si qytetarë dhe të përjetojnë një mënyrë tjetër jete. Një aktivitet vullnetar mund të zgjasë deri në 1 vjet dhe pjesëmarrësit mund të paraqiten vullnetarë për të mbështetur të gjitha llojet e kauzave, qoftë përbrenda ose jashtë Bashkimit Evropian.

Shkëmbimet rinore janë të hapura për të rinjtë e moshës 13-30 vjeç. Shërbimi Vullnetar Evropian është i hapur për të rinjtë e moshës mes 17-30 vjeç.

*'Vetëm për 1 vjet me Shërbimin Vullnetar Evropian, mësova më shumë se kurdoherë. Pa dyshim që do ta rekomandoja shërbimin vullnetar për të gjithë që janë të hapur dhe duan të fitojnë përvojë.'*

Clara (Gjermani) mbi pjesëmarrjen në një projekt për të ndihmuar imigrantët e ardhur së fundmi në Bruksel, Belgjikë, në Qendrën e Komunitetit Jozef Suinnen.

Nëse jeni të interesuar të aplikoni, duhet të kontaktoni agjencinë nacionale në vendin tuaj.

### LËVIZSHMËRIA E STAFIT DHE PUNËTORËT RINORË

Nëse jeni mësimdhënës ose punoni në ndonjë ndërmarrje, mund të ligjëroni në ndonjë institucion jashtë vendit, ku do të fitoni perspektivë të re profesionale, do të zgjeroni rrjetet tuaja dhe do të ndihmoni në modernizimin e sistemeve evropiane të arsimit dhe trajnimit dhe t'i bëni ato më ndërkombëtare.

Mësimdhënësit, personeli jo-akademik dhe punëtorët rinorë gjithashtu mund të ndjekin trajnime jashtë vendit, duke përfshirë kurset e strukturuara, trajnimet gjuhësore me fokus profesional, trajnimet dhe punët në "hije", për të zhvilluar njohuri dhe ide të reja që mund t'i praktikoni kur të ktheheni në vendin tuaj. Këto aktivitete mund të zgjasin nga 2 ditë, deri në 2 muaj.

Nëse jeni të interesuar të aplikoni, duhet t'i drejtoheni institucionit arsimor ose organizatës rinore për të cilën punoni. Stafi i ndërmarrjeve duhet të ftohet nga institucioni i arsimit të lartë ku planifikojnë të ligjërojnë.



© Universitat Bonn/Volker Lannert

Strategjia ndërkombëtare e Universitetit të Bonit përfshin shkëmbimin e shkencëtarëve të rinj, studentëve dhe stafit administrativ.

*‘Përvoja ime ishte puna në “hije” në Federatën e të shurdhërve në Qipro, për të mësuar mbi aktivitetet dhe përvojat e tyre... Kjo përvojë më mundësoi të kuptoj më mirë kulturën qipriote të të shurdhërve, të zhvilloj edhe më tej kompetencat e mia të gjuhës së shenjave dhe të kuptoj më mirë procesin e mësimit, i cili duhet të implementohet gjatë mësimit me nxënësit e shurdhër.’*

Christophe (Francë), instruktur i gjuhës së shenjave, lidhur me punën e tij në “hije” në Qipro

## Veprimi kyç 2: mbështetja për bashkëpunimin dhe partneritetin

A jeni organizatë ose institucion në fushën e arsimit, trajnimit ose rinisë dhe doni të punoni jashtë kufijve me kolegë të sektorit tuaj ose në sektorë të tjerë, apo me botën e punës, në mënyrë që të risoni dhe të modernizoni praktikat tuaja?

A jeni kompani, organizatë hulumtuese, autoritet rajonal, shoqatë, partner socio-ekonomik ose OJQ dhe dëshironi bashkëpunim me organizata ose institucione në fushën e arsimit, trajnimit ose rinisë për të përforcuar bashkëpunimin, transferuar njohuri dhe për të implementuar praktika inovative?

Ekzistojnë edhe lloje të ndryshme të projekteve të partneritetit në Erasmus+, të cilat mund të jenë relevante për ju.

## PARTNERITETET STRATEGJIKE NË FUSHAT E ARSIMIT, TRAJNIMIT DHE RINISË DHE ME BOTËN E PUNËS

Partneritetet strategjike synojnë të zhvillojnë, transferojnë dhe implementojnë arsimin, trajnimit dhe përvojat inovative rinore me anë të bashkëpunimit ndërkufitar mes organizatave të ndryshme.

Për të arritur këto synime, Erasmus+ mbështet organizatat që janë aktive në fushën e arsimit, trajnimit dhe rinisë nga vende të ndryshme. Llojet e aktiviteteve që mund të mbështeten, përfshijnë:

- përpilimin e programeve të përbashkëta të studimit, planprograme të reja, metoda inovative të ligjërimit (për shembull shfrytëzim më i mirë i teknologjive të informimit dhe komunikimit) dhe materialet, metodat dhe përvojat e reja ligjëruese/trajnuese (për shembull për gjuhët);
- rrjetëzimin dhe mësimin nga kolegët, për t'u mundësuar studentëve dhe stafit të mësojnë raste nga jeta e vërtetë me ndërmarrje, duke synuar zhvillimin e një qëndrimi sipërmarrës dhe të menduarit kreativ;
- miratimin e kompetencave të fituara me anë të mësimit jozyrtar dhe joformal në nivel nacional, duke i adresuar ato në kornizat e BE-së dhe duke i referuar ato sipas kornizave të BE-së dhe duke përdorur instrumente të dokumentimit të BE-së.

Si të aplikoni: institucionet arsimore, organizatat rinore ose përfaqësuesit e organizatave të tjera të interesuara duhet të kontaktojnë agjencinë nacionale në vendin e tyre.



© Fotolia/Syda Productions

vetë-përcaktues.



*A jeni të gatshëm të bëni kërcim? Fitoni kualifikime ndërmarrëse në nivel universitar.*

### **ALEANCAT E DITURISË: BASHKËPUNIMI MES INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE NDËRMARRJEVE**

Erasmus+ financon partneritetet e strukturuar mes institucioneve të arsimit të lartë dhe ndërmarrjeve, për të ndihmuar tejkalimin e boshllëkut midis botës së arsimit të lartë dhe punës. Aleancat e diturisë do të ndihmojnë edhe në pajisjen e studentëve dhe stafit me më tepër aftësi sipërmarrëse dhe i bëjnë më sipërmarrëse institucionet e arsimit të lartë dhe kompanitë.

Aleancat e diturisë mund të mbështesin aktivitete që trajtojnë:

- zhvillimin dhe implementimin e metodave të reja të mësimin dhe ligjërimit (siç janë planprogramet e reja multidisiplinare dhe ligjërimi dhe mësimi i përqëndruar te nxënësit dhe në bazë të problemit);
- krijimi i strukturave për mësimin e aftësive të tërthorta dhe mënyrën e zbatimit të tyre në të gjitha programet e arsimit të lartë. Këto duhet të zhvillohen në bashkëpunim me ndërmarrjet, dhe në këtë mënyrë të përforcojnë punësueshmërinë, kreativitetin dhe shtigjet e reja profesionale;
- prezantimi i arsimit për sipërmarrësi dhe qasjet sipërmarrëse në proceset e mësimdhënies dhe mësimin në të gjitha disiplinat; duke ofruar njohuri, aftësi dhe motivim për studentët, hulumtuesit, stafin dhe edukatorët, për t'u angazhuar në aktivitetet sipërmarrëse.

Aleancat e diturisë duhet të përfshijnë minimum gjashtë organizata nga së paku tre vende të ndryshme të programit (me së paku dy ndërmarrje dhe dy partnerë akademikë).

### **ALEANCAT E SHKATHTËSIVE SEKTORIALE: BASHKËPUNIMI MES OFRUESVE TË ARSIMIT DHE TRAJNIMIT PROFESIONAL DHE BOTËS SË PUNËS**

Biznesi dhe industria mendojnë për zinxhirët e furnizimit jashtë-kufitar dhe jo ato nacionalë. Aleancat e shkathtësive sektoriale i përshtasin këto planprograme sipas këtij realiteti dhe ndihmojnë në përgatitjen e të rinjve në arsimin dhe trajnimin profesional për tregun evropian të punës. Aleancat e shkathtësive sektoriale synojnë të ofrojnë shkathtësitë e nevojshme për profesionet e tyre specifike, me anë të:

- trajtimit të mangësive në shkathtësi, duke rritur reagimin e sistemeve fillestare dhe të vazhdueshme të arsimit profesional për nevojat e tregut të punës sipas sektorit;
- punës për të dizajnuar dhe ofruar programe për trajnim profesional jashtë-kufitar dhe metodologji të mësimdhënies dhe trajnimit;;
- zhvillimi i mësimin të bazuar në vend të punës (në shkollë ose në kompani) dhe përvojat për të lehtësuar kalimin nga arsimimi në punë.

Aleancat e shkathtësive sektoriale duhet të përfshijnë së paku nëntë organizata të ndryshme nga së paku tre vende të programit, përfshirë këtu dy Shtete Anëtare

### NDËRTIMI I KAPACITETEVE NË ARSIMIN E LARTË: BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË VENDET PARTNERE

Erasmus+ mbështet projektet e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë në gjithë botën, duke synuar zhvillimin dhe modernizimin e institucioneve të arsimit të lartë në vendet partnere. Institucionet partnere mund të zgjidhen në vendet fqinje të BE-së, në Ballkanin Perëndimor, në Rusi, si dhe në rajonet në Azi, Amerikë Latine, dhe vendet e Afrikës, Karaibeve e Paqësorit.

Projektet e ardhshme mund të përfshijnë:

- projektet e përbashkëta që përpilojnë planprograme dhe shkallë të reja, metodologji të mësimit dhe mësimdhënies, zhvillimin e stafit, vlerësimin e cilësisë, qeverisjs së re dhe strukturave e proceseve menaxhuese;
- projektet për zhvillimin e reformave strukturore në nivel nacional me mbështetjen e autoriteteve në vendet partnere (për shembull modernizimi i politikës, menaxhimi i sistemeve të qeverisjes dhe menaxhimit të sistemeve të arsimit të lartë).

### NDËRTIMI I KAPACITETEVE NË FUSHËN E RINISË: BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT RINORE NË VENDET PARTNERE

Erasmus+ mbështet projektet e bashkëpunimit midis organizatave, të cilat janë aktive në fushën e rinisë në gjithë botën. Këto projekte kanë për qëllim të përmirësojnë cilësinë dhe ta njohin punën rinore, mësimin jozyrtar dhe vullnetarizmin në rajone të ndryshme të botës — sidomos në vendet në zhvillim.

Shembujt e aktiviteteve përfshijnë:

- bashkëpunimin, rrjetëzimin dhe mësimin nga kolegët në mes të organizatave rinore;
- punën e përbashkët në rritjen e vetëdijes dhe njohjen e vullnetarizmit dhe mësimi jozyrtar në vendet partnere;
- zhvillimi dhe implementimi i praktikave dhe mjeteve të mira për zhvillimin profesional të këshilltarëve rinorë dhe trajnuesve.
- këmbimet rinore, vullnetarizmi jashtë vendit dhe lëvizshmëria e punëtorëve rinorë.

### MJETET ONLINE PËR MËSIMDHËNËSIT E SHKOLLAVE DHE PËR ARSIMIN E TË RRRITURVE

**eTwinning** mbështet dhe përforcon bashkëpunimin midis shkollave, duke ofruar përkrahje, mjete të dobishme dhe një vend për të punuar së bashku online. eTwinning mund të përdoret për të mbështetur projektet e lëvizshmërisë ose partneritetet strategjike, ose për të bashkëpunuar online.

Përveç kësaj, eTwinning kontribuon në zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe stafit, duke ofruar materiale mësimore onlajn dhe mundësi për rrjetëzim në mbarë Evropën.

Te gjitha shkollat dhe institucionet parashkollore në vendet e programit janë të mirëseardhura të përdorin eTwinning në çdo kohë, pas regjistrimit në portalin e eTwinning: <http://www.etwinning.net>.

**EPALE** (shkurtesa për Platformën Elektronike të Mësimi për të Rritur në Evropë) është një hapësirë online ku politikëbërësit, edukatorët, pjesëmarrësit dhe të gjithë të involvuarit në ofrimin e arsimit për të rritur mund të këmbëjnë informata dhe ide, ose të shfaqin dhe të shpërndajnë metoda të praktikës së mirë në arsimin për të rritur. Këtu krijohen komunitetet e stafit për arsim të të rriturve në gjithë BE-në. Platforma do të jetë në dispozicion në fund të vitit 2014.

### Veprimi kyç 3: mbështetja për reformën e politikës

Erasmus+ mbështet aktivitetet që synojnë arritjen e qëllimeve të strategjisë Evropa 2020, kornizën strategjike të Arsimit dhe Trajnimit 2020 dhe strategjitë e tjera specifike sipas sektorit, siç është procesi i Bolonjës në arsimin e lartë. Këto aktivitete përfshijnë grumbullimin e fakteve, studimet dhe analizat e temave ose vendeve të caktuara, projektet e bashkëpunimit mes autoriteteve publike ose organizatave kryesore, si dhe konsultimet me qeveritë dhe organizatat qytetare. Ato gjithashtu inkurajojnë takimet midis të rinjve dhe vendimmarrësve në kontekst të Dialogut Strukturor me të rinjtë.

Aktivitetet kanë për qëllim të përmirësojnë cilësinë dhe efikasitetin e arsimit, sistemeve trajnuese dhe politikat rinore, të promovojnë angazhimin në reformën e politikës, të rrisin vetëdijen, mësimin reciprok, bashkëpunimin jashtë kufijve, të zhvillojnë njohuri dhe të inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të të rinjve në jetën demokratike.

## Perspektiva

Në periudhën prej 2014 deri në vitin 2020, rreth 4 milionë njerëz dhe 125 000 institucione do të përfitojnë drejtpërdrejtë nga Erasmus+.

### Shifrat kryesore: Erasmus+ (2014–20)

Buxheti i përgjithshëm	14.7 miliardë euro. Fonde shtesë do të ndahen për financimin e veprimeve me vendet e treta (vendet partnere).
Mundësitë e përgjithshme të lëvizshmërisë	Më shumë se 4 milionë njerëz
Arsimi i lartë	Rreth 2 milionë studentë
Studentët e arsimit dhe trajnimit profesional	Rreth 650 000 studentë dhe stazhistë
Lëvizshmëria e stafit	Rreth 800 000 ligjërues, mësime dhënë, instruktorë, personel arsimor dhe këshilltarë rinorë
Skemat e vullnetarizmit dhe këmbimit të të rinjëve	Më se 500 000 të rinj
Skema e granimit të kredive për shkallën master	Rreth 200 000 studentë
Shkallët e përbashkëta Master	Më se 25 000 studentë
Partneritetet strategjike	Rreth 25 000 partneritete strategjike që bashkojnë 125 000 shkolla, arsim profesional dhe institucione trajnuese, institucione të arsimit të lartë dhe për të rritur, organizata rinore dhe ndërmarrje
Aleancat e diturisë	Më shumë se 150 Aleanca Njohurie të themeluara nga 1 500 institucione të arsimit të lartë dhe ndërmarrje
Aleancat e shkathësive sektoriale	Më se 150 aleanca për kualifikime sektoriale të themeluara nga 2 000 provajderë të arsimit dhe trajnimit profesional dhe ndërmarrje

## Mësoni më tepër

- ▶ Informata të përgjithshme mbi arsimin dhe trajnimin në nivel evropian: <http://ec.europa.eu/education>
- ▶ Informata të përgjithshme mbi politikën rinore në nivel evropian: <http://ec.europa.eu/youth>
- ▶ Erasmus+: <http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>
- ▶ Agjencia ekzekutive: <http://eacea.ec.europa.eu>
- ▶ Agjencitë nacionale: [http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/national-agencies\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/national-agencies_en.htm)
- ▶ Këndi i mësime dhënë: <http://europa.eu/teachers-corner>

Këndi i mësime dhënë ofron materiale arsimore mbi bashkimin Evropian në 23 gjuhë. Përmban të gjitha llojet e materialeve (webfaqe, broshura, lojëra online, video, etj.) të dizajnuara për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme. Mësime dhënë do të gjejnë shumë frymëzim këtu, nëse duan t'ua mësojnë nxënësve historinë e BE-së, mënyrën se si funksionon apo çfarë bën BE-ja ose të diskutojnë lidhur me politikat e BE-së në hollësi. Të gjitha burimet e mësime dhënë janë pa pagesë.

- ▶ Portali Rinor Evropian: <http://europa.eu/youth>  
Portali Rinor Evropian ofron informata dhe mundësi për të rinjtë në gjithë Evropën.
- ▶ Pyetje mbi Bashkimin Evropian? Europe Direct mund të ndihmojë 00 800 6 7 8 9 10 11 — <http://europedirect.europa.eu>